

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5776
E martë, 14 maj 2019
çmimi 0.40 €

Thaçi: Kuvendi i bashkuar duhet ta dënojë gjenocidin serb dhe të kërkojë drejtësi



FAQE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**BALLKANI
PERËNDIMOR,
NE BESOJMË
TE BIZNESI!**



F.11
Nga Majlinda
BREGU

**MBI 57 MIJË QYTETARË
ME TË DREJTË VOTE PËR
ZGJEDHJET LOKALE NË VERI**

F.7

**RRITET DYFISH NUMRI I
KORONAROGRAFIVE DHE
STENTIMEVE NË QKUK**

F.7



EKONOMI

**UDHËHEQËSIT E ARSIMIT
PROFESIONAL TË IOWAS
VIZITOJNË QENDRËN E
TRAJNIMEVE TË KEK-ut**

F.8

**MUNDËSI PUNËSIMI DHE
TRAJNIMI PËR MË SHUMË
SE 240 PUNËKËRKUES**

F.9

KULTURË

**NË UPZ U HAP BIBLIOTEKA
AUSTRIAKE ME MBI
2 000 TITUJ TË LIBRAVE**

F.18



FLET PËR "EPOKËN E RE", BARDHYL MAHMUTI | FAQE 4-5

Kosovës nuk i duhet një vendim i përshpejtuar i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

Politologu Bardhyl Mahmuti ka thënë se Kosova nuk është vonuar për ta paditur Serbinë për gjenocidin e kryer në Kosovë. Përkundrazi, ai ka theksuar se në kontekstin politik dhe shoqëror nëpër të cilin po kalojmë çdo përshpejtim i akuzës do të kishte

qenë në favor të Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bardhyl Mahmuti ka deklaruar se Kosovës nuk i duhet një vendim i përshpejtuar i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, por një vendim i drejtë që do ta ndëshkonte

gjenocidin serb në Kosovë. Ai ka thënë se tribunali për krimet serbe në Kosovë mund të realizohet nëpërmjet shtimit të amendamenteve në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar

ËSHTË MBAJTUR TRYEZA "KUADRI KUSHTETUES I PROCESIT TË DIALOGUT KOSOVË - SERBI" | FAQE 3

Ndryshimi i kufijve nuk është zgjidhje

Ideja e ndryshimit të kufijve në procesin e dialogut Kosovë - Serbi sërish është kundërshtuar nga njohësit e së drejtës kushtetuese dhe njohësit e rrethanave politike në vend. Në tryezën e organizuar nga Instituti EPIK, me temë "Kuadri kushtetues i procesit të dialogut Kosovë - Serbi", ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, dhe politologu Belul Beqaj kanë thënë se lëvizja e kufijve nuk është zgjidhje. Sipas tyre, për këtë çështje duhet zgjidhje evropiane, transparente dhe unitet i faktorit politik vendor



**Më 15
qershor hiqet
roamingu
ndërmjet
Kosovës dhe
Shqipërisë**

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vuesha, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Pritjet nga presidenti i ri i Maqedonisë së Veriut

Njohës të çështjeve politike vlerësojnë se presidenti i ri i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, do t'i ndryshojë raportet e këtij institucioni me qeverinë, por edhe me komunitetin ndërkombëtar

SHKUP, 13 MAJ - Presidenti i ri i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, do t'i ndryshojë raportet e këtij institucioni me qeverinë, por edhe me komunitetin ndërkombëtar, bazuar në vlerësimet e njohësve të çështjeve politike. Paraprakisht edhe partitë në pushtet, të udhëhequra nga Lidhja Social-Demokrate (LSDM), që e kishin nominuar dhe zgjedhur për president, kanë thënë se me Stevo Pendarovskin në krye të shtetit do ta vazhdojë kursin euroatlantik të qeverisë si dhe konceptin e saj "Një shoqëri për të gjithë".

Albert Musliu, analist dhe drejtues i Shoqatës "Iniciativa demokratike", beson se vendi përfundimisht do t'i japë fund bllokimit të procesit të reformave nga presidenti i deritanishëm, Gjorge Ivanov, i cili kishte refuzuar dekretimin e dhjetëra ligjeve për shkak të mospranimit të emrit të ri të shtetit, Maqedonia e Veriut, ndërsa kishte mbajtur zvarrë edhe shumë vendime të tjera në politikën e jashtme si emërimin e ambasadorëve, por edhe ratifikimin e marrëveshjeve dypalëshe. "Gjithsesi se me zgjedhjen e këtij presidenti dhe nëse ai i përmbush premtimet që i ka dhënë gjatë fushatës, por edhe mbremjen kur u kumtua se është zgjedhur president, mendoj se gjithë procesin e përshpej-

ton jo vetëm për faktin se nuk do të ketë dilema për nënshkrimin e ligjeve që janë me rëndësi për Maqedoninë e Veriut, por ai do t'u japë një impuls pozitiv edhe raporteve të vendit me partnerët tanë euroatlantikë. Mendoj se do të kemi një president më të përgjegjshëm dhe më vizionar lidhur me ardhmërinë euroatlantike të shtetit", thotë Musliu. Presidenti i ri, Stevo Pendarovski, në postin e kreut të shtetit u zgjodh edhe me votat e shqiptarëve të cilat ishin vendimtare në fitoren e tij. Musliu thotë se ai do të jetë ndryshe nga tani me ish-presidentin Ivanov, i cili kishte refuzuar dekretimin e Ligjit për gjuhën shqipe, si dhe zgjidhje të tjera që kanë të bëjnë me shqiptarët. "Pikë së pari mendoj se presidenti i ri do ta respektojë plotësisht Ligjin e ri për përdorimin e gjuhëve. Nga ana tjetër, nuk besoj se ai do të bëjë zgjedhje politike të personave sa për t'u parkuar në presidencë. Pres që të mos ketë dilema në këtë temë dhe se relacionet me shqiptarët do të shënojnë një përmirësim më rrënjësor apo përmbajtësor", thotë Musliu.

Ish-presidenti Gjorge Ivanov pas përfundimit të mandatit nuk e ka përjashtuar mundësinë e shkuarjes në pension, pasi ligji aktual i jep privilegje të shumta, pagë të njëjtë sikur edhe presi-



dentit në detyrë, kabinet të posaçëm, të paktën katër punonjës e përfitime të tjera. Njohësit e çështjeve juridike thonë se ky ligj duhet të ndryshojë meqë, pas përfundimit të mandatit, ish-presidentët mund ta vazhdojnë angazhimin e tyre në sfera të ndryshme. "Megjithatë, duhet të punojnë apo të jenë në shërbim të shoqërisë. Janë njerëz që vërtet mund të kontribuojnë dhe ata mund të bëjnë një gjë të tillë nëse u shkurtohen privilegjet. Veç kësaj, ne jemi shtet i varfër dhe nuk duhet të lejojmë që

persona të tillë, pavarësisht se kanë qenë në poste të larta, të jenë të privilegjuar. Ivanovi është i ri në moshë dhe mund të japë kontribut në profesionin e tij, por edhe në sfera të tjera të shoqërisë. Mund t'i jepet pension derisa të gjendet në shoqëri, por nuk mendoj se duhet t'i jepet pension deri në fund të jetës", thotë Temellko Ristevski, njohës i çështjeve juridike.

Ndryshe, presidenti i ri, Stevo Pendarovski, ka marrë urime të shumta me rastin e fitores në zgjedhjet presidenciale si nga përfaqësues të Bashkimit

Evropian, po ashtu edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Stevo Pendarovski ka thënë se do të jetë presidenti i të gjithë qytetarëve pa dallim të përkatësisë së tyre etnike, fetare apo politike dhe se qëllimi kryesor i tij do të jetë uniteti e jo ndarja e popullit dhe realizmi i aspiratave për anëtarësim në NATO dhe BE. Ai në balotazhin e 5 majit me rreth 60 mijë vota dallim munda kandidaten e opozitës maqedonase, Gordana Siljanovska-Davkova. Mandati i presidentit të Maqedonisë së Veriut zgjat pesë vjet.

Protestuesit pushtojnë sheshin e Tiranës

TIRANË, 13 MAJ - Mijëra protestues kanë pushtuar bulevardin kryesor të Tiranës të hënë në mbrëmje, ndonëse shiu binte me furi. Asnjë nuk e ndjenë shiun, por bërtisnin "Rama, ik!" Në këtë protestë nga Sheshi "Skenderbej" deri te Sheshi "Nënë Tereza" kishte plot e plot protestues. Ndërkohë mbi 1 500 forca policie kishin rrethuar kryeministrinë.

Ambasada Amerikane në Tiranë u ka bërë të hënë thirrje kryetarit të Partisë Demokratike dhe drejtueses së Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi, "ta dënojnë dhunën në protestën e së

shtunës dhe të sigurojnë se protestat e ardhshme do të jenë paqësore". Deklarata e Ambasadës Amerikane u bë të hënë pasdite para nisjes së protestës që mbajti opozita në mbrëmje. Ambasada thekson se "forca dhe dhuna nuk kanë vend në një proces demokratik" dhe se ato dënojnë "dhunën e pranishme gjatë protestave të 11 majit në Tiranë dhe përgjegjësit e saj". Mediet në Tiranë kanë njoftuar se kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, nuk ka marrë pjesë në protestën e së hënës, meqë ndodhet në një vizitë pune në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



Është mbajtur tryeza "Kuari kushtetues i procesit të dialogut Kosovë - Serbi"

Ndryshimi i kufijve nuk është zgjidhje

Ideja e ndryshimit të kufijve në procesin e dialogut Kosovë - Serbi sërish është kundërshtuar nga njohësit e së drejtës kushtetuese dhe njohësit e rrethanave politike në vend. Në tryezën e organizuar nga Instituti EPIK, me temën "Kuari kushtetues i procesit të dialogut Kosovë - Serbi", ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, dhe politologu Belul Beqaj kanë thënë se lëvizja e kufijve nuk është zgjidhje. Sipas tyre, për këtë çështje duhet zgjidhje evropiane, transparencë dhe unitet i faktorit politik vendor



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 13 MAJ - Njohësit e së drejtës kushtetuese dhe analistët politikë kanë kundërshtuar idenë e korrjigimit të kufijve në procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Në tryezën "Kuari kushtetues i procesit të dialogut Kosovë - Serbi" të organizuar nga Instituti EPIK, ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani dhe politologu Belul Beqaj kanë thënë se ndryshimi i kufijve nuk është zgjidhje.

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, ka thënë se korrjigimi i kufijve nuk zgjidh asgjë, por vetëm komplikon marrëdhëniet në mes të popujve. "Copëtimi, jo vetëm që nuk do të zgjidhte asgjë por, siç e tregon historia, komplikon më shumë marrëdhëniet në mes të popujve duke ua dhënë marrëdhënieve të tilla dimensionin e problemeve afatgjata. Në vend të kësaj duhet të promovohet dhe ofrohet një zgjidhje evropiane që nuk bazohet në gjymtimin territorial, por në sundim të ligjit, respek-

tim të të drejtave të njeriut dhe minoriteteve", ka thënë ai.

Hasani ka treguar se rasti i Greqisë dhe Maqedonisë për emrin e kësaj të fundit nuk duhet të krahasohet me rastin Kosovë - Serbi. "Kontestimi Greqi - Maqedoni e Veriut dalton në aspektin fundamental nga rasti Kosovë - Serbi. Në rastin e fundit, kontestimi bëhet lidhur me qenien shtet të Kosovës, të cilën Serbia dhe shoqëria e saj e shohin si pjesë administrative të shtetit mesjetar serb - si një Jerusalem serb", ka thënë Hasani. Sipas tij, rruga kushtetuese që ka ndjekur Maqedonia e Veriut për ta arritur marrëveshjen ka qenë në harmoni me të drejtën kushtetuese dhe standardet e së drejtës ndërkombëtare. "Përfaqësuesve të sovranit në Maqedoni iu është dhënë vend i spikatur gjatë procesit, pse jo vetëm në rastin e ratifikimit të Marrëveshjes së Prespës, duke e angazhuar si palë mbikëqyrëse dhe në mënyrë transparente. Në Kosovë ky nuk ka qenë rasti dhe nuk është as sot e kësaj dite, sepse infrastruktura ligjore dhe organizative e procesit të dialogut ka dalë jashtë binarëve

kushtetues, ashtu siç u pat nisur në vitin 2011. Prandaj kjo duhet kthyer mbrapa ashtu që çdo gjë të ecë në rrugë kushtetuese dhe sipas standardeve ndërkombëtare për krijimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërmjet shteteve sovraane dhe të pavarura", është shprehur ai. Edhe profesori i shkencave politike, Belul Beqaj, e ka kundërshtuar idenë për ndryshimin e kufijve. "Sikur ideja për ndarje të ishte paraprakisht e mbështetur nga sovranit dhe ekzistonte unanimiteti i faktorëve me ndikim ndërkombëtar lidhur me këtë, atëherë përfaqësuesi i sovranit do të kishte bazë politike për ta negociuar edhe çështjen e territorit si një nga elementet bazë të shtetformimit. A nuk po nxitet me këtë qasje ideja e ndarjes, për faktin se po negociojmë për ndarje?!", ka thënë Beqaj. Ai ka deklaruar se marrëveshja përfundimtare

me Serbinë duhet të jetë e harmonizuar me të gjithë faktorët politikë në vend. "Kemi çakordim të liderëve. Presidenti tenton ta imponojë vullnetin politik. Kjo është një pengesë serioze politike. Sikur ideja për ndarjen të ishte e mbështetur nga sovranit dhe uniteti i faktorit ndërkombëtar, që aktualisht nuk ekziston, atëherë përfaqësuesit do të kishin bazë për të negociuar edhe territorin", ka deklaruar Beqaj. Kurse menaxherja e projekteve në KDI, Jeta Krasniqi, ka kërkuar transparencë më të madhe në këtë proces dhe përfshirje sa më të madhe të kuvendit. "Kuvendi të ketë rol qendror në procesin e dialogut dhe marrëveshja eventuale me Serbinë të ratifikohet me dy të tretat e votave të deputetëve. Miratimi i ligjit në mars pamë që nuk arriti të krijojë rend kushtetues mes institucioneve. Kërkesa e delegacionit që ata të pyeten për marrëveshjen finale

del përtej kornizës kushtetuese, pasi është ndërhyrje në mes të pushteteve", ka thënë Krasniqi. Gjatë tryezës Instituti EPIK ka prezantuar studimin për kuadrin kushtetues relevant për dialogun Kosovë - Serbi. Gjatë prezantimit të studimit, Taulant Kryeziu ka thënë se çdo segment i këtij dialogu duhet të jetë në kuadër të Kushtetutës së Kosovës. "Në këtë analizë mëtohet që të vihet brenda kuadrin kushtetues çdo negociim dhe dialogim i Kosovës me Serbinë. Arsyetja për këtë qasje ka të bëjë mbi të gjitha me faktin e thjeshtë se Kushtetuta përbën dokumentin më sublim të secilës shoqëri moderne, duke përcaktuar parametrat e ushtrimit të pushtetit, formën dhe përmbajtjen e tij, rolin e individit kundrejt këtij pushteti dhe, mbi të gjitha, bartësin e sovranitetit dhe mënyrën e ushtrimit të tij", ka thënë Kryeziu.

Tahiri: 2019-ta është vit i jetësimit të reformave shtetërore

PRISHTINË, 13 MAJ - Koordinatorin nacional për reforma shtetërore, Besnik Tahiri, ka bërë me dije se 2019-ta është vit i jetësimit të reformave shtetërore. Në takimin e Këshillit të Ministrave për Reformën e Administratës Publike ai i ka njoftuar të pranishmit për hapat e ndërmarrë për Ligjin e qeverisë dhe reformat në fushën e inspektiveve. "Ky mekanizëm ka rol kyç në koordinimin ndërministror për t'i shtyrë përpara reformat në proces dhe zbatimin efikas të proceseve reformuese të ndërmarra deri më tani. Për ta përmbyllur reformën e Administratës Publike në dinamikë të shpejtë do të miratohet Projektligji për qeverinë, që për

synim ka ta kthejë ekzekutivin në një mekanizëm efikas të zbatimit të legjislativitetit dhe detyrave integruese", ka deklaruar Tahiri. Në këtë kuadër ai ka thënë se janë dy synime kyçe: forcimi i qeverisjes së mirë dhe sundimi i ligjit në njërin anë ndërsa, në anën tjetër, përmes Projektligjit për inspektimet dhe ligjeve të tjera sektoriale synohet të përmirësohen radikalisht konkurrencshmëria dhe klima e investimeve. "Në kuadër të agjendës së reformave rol kyç luan mbështetja për nivelin lokal si mekanizëm i veçantë për zhvillim të qëndrueshëm dhe përshpejtim të integritetit. Në këtë kuadër, qeveria synon ta forcojë



koordinimin me partnerët zhvillimorë për ndjekjen e agjendës së reformave për vendin. Pavarësisht prej sfidave, reformat e ndërmarra

kanë marrë konfirmimin e qartë për rezultatet e arritura, vlerësime këto që i hapin rrugë procesit integruese. Këto rezultate inkura-

juese janë të rëndësishme për ta avancuar edhe më tutje dinamikën e reformave shtetërore", është shprehur Tahiri.

FLET PËR "EPOKËN E RE", BARDHYL MAHMUTI

Kosovës nuk i duhet një vendim i përshpejtuar i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë



Politologu Bardhyl Mahmuti ka thënë se Kosova nuk është vonuar për ta paditur Serbinë për gjenocidin e kryer në Kosovë. Përkundrazi, ai ka theksuar se në kontekstin politik dhe shoqëror nëpër të cilin kalojmë çdo përshpejtim i akuzës do të kishte qenë në favor të Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bardhyl Mahmuti ka deklaruar se Kosovës nuk i duhet një vendim i përshpejtuar i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, por një vendim i drejtë që do ta ndëshkonte gjenocidin serb në Kosovë. Ai ka thënë se tribunali për krimet serbe në Kosovë mund të realizohet përmes shtimit të amendamenteve në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 13 MAJ -

"Epoka e re": Z. Mahmuti, para disa ditësh publikuar një letër drejtuar deputetëve të Kuvendit të Kosovës, së cilës i bashkëngjitet një Projektrezolutë për gjenocidin serb në Kosovë. Iniciativa u prit mirë dhe këtë javë pritet që Kuvendi i Kosovës ta miratojë këtë projekt. Çfarë mund të thoni lidhur me këtë çështje?

Bardhyl Mahmuti: Pavarësisht se një numër i konsiderueshëm i politikanëve shqiptarë denoncojnë Serbinë për gjenocid gjatë luftës në Kosovë, është fakt se nuk kemi asnjë vendim të institucioneve shtetërore që e kualifikojnë krimin e shtetit serb si të tillë. Fatkeqësisht, disa iniciativa

këtij projekti dhe atyre që do ta miratojnë. Miratimi i një rezolute të tillë do të shënojë një hap përpara drejt harmonizimit të qëndrimeve rreth kualifikimit të krimeve gjatë luftës në Kosovë dhe do ta krijojë bazën e nevojshme për amendamentet në ligjin e Kosovës me të cilat do të dënoheshin të gjithë ata që mohojnë gjenocidin serb në Kosovë. Përveç aspekteve të brendshme, kjo rezolutë do të hapë mundësi që të punohet në rrafshin ndërkombëtar, me qëllim të përhapjes të së vërtetës së në Kosovë ka ndodhur gjenocidi.

"Epoka e re": Shpesh dëgjohet se jemi vonuar dhe se është dashur shumë më herët të bëjmë padi kundër Serbisë për krimin e gjenocidit. A mendoni se jemi vonuar në këtë drejtim?

Bardhyl Mahmuti: Jo. Nuk jemi vonuar për të bërë padinë për gjenocidin serb në Kosovë. Përkundrazi, në kontekstin politik dhe shoqëror nëpër të cilin kalojmë, çdo përsheptim i akuzës do të kishte qenë në favor të Serbisë. Të mos harrojmë se edhe në mesin tonë nuk ka konsensus rreth kualifikimit të asaj që ka ndodhur në Kosovë gjatë luftës. Njëri godet thumbin e tjetri patkoin. Me keqardhje duhet të pranojmë se një numër i konsiderueshëm i politikanëve dhe gazetarëve që kanë një rol të madh në krijimin e opinionit publik nuk e kanë të harmonizuar terminologjinë që përdorin kur bëhet fjalë për krimet serbe në Kosovë. Në rrafshin ndërkombëtar gjendja është tejet e pafavorshme për ne. Në vend se të ndëshkohet Serbia për gjenocidin që ka kryer në Kosovë, sot kemi krijimin e një gjykate që do t'i trajtojë sajatat e Shërbimit Sekret Serb kundër UÇK-së. Ai i cili do të kishte ngritur padi kundër Serbisë në këtë kontekst ndërkombëtar do t'i kishte bërë shërbim të madh Serbisë, sepse vendimi do të kishte qenë i disfavorshëm për ne. Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina ngritën akuza kundër Serbisë për krim të gjenocidit pa krijuar paraprakisht kontekstin e favorshëm në opinionin publik ndërkombëtar. Rezultati final ishte negativ, sepse Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë hodhi poshtë akuzat kundër Serbisë. Kosovës nuk i duhet një vendim i përsheptuar i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, por një vendim i drejtë që do ta ndëshkonte gjenocidin serb në Kosovë. Për t'i rritur gjasat e realizimit të ngadhënjimit të drejtësisë duhet të punojmë shumë si në rrafshin ndërkombëtar, po ashtu edhe në atë të brendshëm. Në të kundërtën do të korrim rezultate negative. Me një fjalë, ai i cili do të shpejtonte të ngrihej akuza për gjenocid kundër Serbisë, në këtë kontekst të raportit të forcave në skenën politike ndërkombëtare, do të bënte një veprim antikombëtar.



"Epoka e re": Në çfarë drejtimi duhet të orientohet puna sqaruuese e opinionit publik ndërkombëtar që të rritet mbështetja për ngadhënjimin e drejtësisë?

Bardhyl Mahmuti: Po marr shembull dëshminë e Vasfije Krasniqit para Kongresit Amerikan për dhunën seksuale dhe tmerrin që ka përjetuar gjatë luftës. Dhuna seksuale ndaj femrave shqiptare përbën krim të gjenocidit në kuptimin si përkufizohet gjenocidi me Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, sepse Neni II, paragrafi (b) i kësaj, cilëson si forma të gjenocidit edhe cenimin e rëndë të integritetit fizik ose mendor. Shihni reagimin e Serbisë pas kësaj dëshmie. Thjesht janë tërbuar, sepse janë të vetëdijshëm se kjo formë e komunikimit do ta nxjerrë në dritë të vërtetën për krimet e tyre. Një segment tjetër i veprimtarisë është shpërndarja në qarqet universitare në botë të veprave që ndriçojnë këto aspekte të luftës në Kosovë, sepse në universitete krijohen politikanët, historianët, gazetarët, sociologët dhe intelektualët e profileve të ndryshme të çdo vendi. Duhet t'u ofrohet mundësia që të njihen me të vërtetën e gjenocidit serb në Kosovë.

"Epoka e re": Z. Mahmuti, si e keni parë iniciativën e institucioneve për themelimin e një tribunali ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë? A është e vonuar kjo iniciativë duke pasur parasysh se po bëhen 20 vjet prej kur ka përfunduar lufta dhe deri më tani vetëm pjesëtarët e UÇK-së janë gjykuar dhe dënuar për krime të luftës nga drejtësia vendore dhe ndërkombëtare?

Bardhyl Mahmuti: Edhe pas dy dekadash nga koha kur në Kosovë shteti serb kreu gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krime të luftës, drejtësia nuk ka ngadhënjyer. Mbi dhjetë mijë familje të 1 392 fëmijëve të

vrarë, të 1 739 grave të vrara dhe mijëra civilëve të tjerë të të gjitha moshave që u vranë gjatë luftës në Kosovë presin drejtësi; Mbi njëzet mijë gra shqiptare ndaj të cilave u përdor dhunua seksuale presin drejtësi; Mbi 1 600 familje shqiptare, të cilët ende nuk dinë për fatin e më të dashurve të tyre, presin drejtësi. Lista e krimeve të pandëshkuara të shtetit serb gjatë luftës në Kosovë është shumë e gjatë. Këto fakte e bëjnë legjitime iniciativën për krijimin e një gjykate që do t'i ndëshkonte krimet të cilat nuk vjetërsohen asnjëherë. Mirëpo, për të krijuar një gjykatë ndërkombëtare që do ta ndiqte zinxhirin komandues dhe kriminelët që kryen gjenocid në Kosovë, duhet që OKB-ja të sjellë vendim për këtë gjë. Fatkeqësisht, në Këshillin e Sigurimit të OKB-së ka shtete që do të përdornin të drejtën e vetos për ta bllokuar çdo iniciativë që ndëshkon Serbinë. Për këtë arsye e vetmja rrugë që të jemi sa më efikas në këtë çështje mbetet të shqyrtohet mundësia e amendamenteve në Ligjin Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Shtimi i amendamenteve që do ta hapte rrugën e krijimit të dhomave të veçanta për të gjitha krimet e kryera nga Serbia gjatë luftës në Kosovë është rruga më e sigurt dhe me më pak pengesa për realizimin e tribunalit për krimet gjatë luftës në Kosovë.

"Epoka e re": Në kohën kur pjesëtarët e UÇK-së po intervistohen nga Gjykata Speciale, Dick Marty ka paralajmëruar dëshmi të reja, kinse për krime të luftës në Kosovë. si e komentoni këtë fushatë të tij dhe të Serbisë kundër Kosovës?

Bardhyl Mahmuti: Reagimet e tërbuara të Serbisë janë të ndërlydhura me vendimet që kanë marrë institucionet e Kosovës. Krijimi i ushtrisë së Kosovës, taksa 100 për qind për produktet e Serbisë, dëshmia e Vasfije Krasniqit para Kongresit Amerikan, projektrezoluta për

gjenocidin serb, iniciativa për tribunal që do t'i ndëshkonte krimet serbe në Kosovë, mundësojnë shpjegimin e mënyrës së sjelljes së shtetit serb dhe medie të kontrolluara prej tij. Në këtë kontekst duhet të shihet edhe mobilizimi i argatëve të këtij shteti, të llojit të Dick Martyt, që pranuan ta vënë emrin e vet në raportin e përpiluar nga Shërbimi Sekret i Serbisë. Nuk më habit aspak nëse Dick Marty do të përpiqet të dorëzojë lloj-lloj 'dëshmi të reja' të cilat do t'ia përpilojë Shërbimi Sekret i Serbisë. Nuk mund t'i di me saktësi të gjitha motivet të cilat e detyrojnë Dick Martyn të veprojë në këtë mënyrë, por sikur të ishte i pavarur në gjykimet e veta, pasi që ka lexuar librin tim, Dick Marty do t'i kërkonte falje popullit shqiptar, në veçanti UÇK-së për vendosjen e emrit të vet në një raport të përpiluar nga një shërbim sekret që është i mbështetur në sajata të pavërteta. Ne nuk duhet të habitemi për sjelljen e tillë të Serbisë, për arsye se në të gjitha nivelet e institucioneve shtetërore janë njerëzit e edukuar dhe ngritur politikisht nga Slllobodan Millosheviqi. Si konkluzion për atë pse Serbia vepron në këtë mënyrë dhe a ka gjasa që ky shtet ta ndryshojë qëndrimin për atë që ka ndodhur në Kosovë, po e citoj gazetarin serb Miroslav Filipoviçin, i cili, për shkak ngritur zërin kundër krimeve serbe në Kosovë, u dënua me 7 vjet burg nga shteti serb. Në analizën e tij të titulluar 'Marshi i gjatë drejt së vërtetës për krimet', Miroslav Filipoviç thotë: "Në Perëndim Millosheviçin moti e kanë quajtur 'kasap të Ballkanit' dhe e kanë krahasuar me Hitlerin. Gjermania e para Luftës së Dytë nuk mund të krahasohet me Serbinë e fillimit të viteve të nëntëdhjeta. Kur Hitleri filloi të çartet dhe t'i ngajë një kafshe të tërbuar, e braktisën një numër i intelektualëve, i shkencëtarëve dhe i artistëve më eminentë të popullit gjerman. Edhe pse Serbinë e Millosheviçit e braktisën një numër artistësh, shkencëtarësh dhe intelektualësh, shumica e tyre u vunë në shërbim të tij, përkundër asaj se e dinin se me urdhrin e tij, me miratimin e tij ose, së paku, me dënimin e tij, çdo ditë 'nga dora serbe' pësonin qindra njerëz të pafajshëm. Tani, të kërkohet nga këta njerëz që të flasin për krimet që janë bërë, do të thotë të kërkohet nga ata që ta pranohet fajësinë e tyre". Më qartë nuk ka si të thuhet! Për arsyet e lartpërmendura askush nuk duhet të habitet pse në Ditën e Evropës, kur bota e civilizuar feston ngadhënjimin ndaj nazizmit, Serbia organizoi paradën ushtarake në Nish të udhëhequr nga gjenerali serb i dënuar për krime gjatë luftës në Kosovë, Vladimir Llazareviç.

të mëparshme dështuan dhe i fundit në këtë drejtim ishte propozimi i PDK-së i datës 27 mars 2015. Tani kemi një frymë pozitive rreth kësaj çështjeje dhe merita u takon të gjithë deputetëve që kanë punuar për të pasur qëndrime të njëjta rreth

Kuvendi më 16 maj mban seancë për tribunalin për gjenocidin serb në Kosovë

PRISHTINË, 13 MAJ (ER) - Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur të hënën, të drejtuar nga Kadri Veseli, kryetar, në të cilën morën pjesë edhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përcaktuar agjendën e punës së Kuvendit për këtë javë. Kështu, kryesia vendosi që sot (e martë) në orën 10:00 Kuvendi të mbledhet në seancë të jashtëzakonshme, sipas kërkesës së 40 deputetëve, për të diskutuar lidhur me gjendjen në Telekomin e Kosovës dhe masat që i ka ndërmarë Qeveria e Kosovës në zbatimin e Rezolutës nr. 06-R-013,

dt. 12.07.2018, lidhur me gjendjen financiare në Telekom dhe Postën e Kosovës.

Ndërkaq të mërkurën, më 15 maj, do të vazhdojë seanca me pikat e mbetura nga seancat e kaluara. Të enjten, më 16 maj, në orën 10:00, Kuvendi do të mbajë seancë të rregullt plenare, në të cilën do të shqyrtohet iniciativa e kryeparlamentarit Kadri Veseli për tribunalin për gjenocidin serb në Kosovë.

Pas deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, pikë e rendit të ditës do të jetë shqyrtimi i propozimrezolutës për gjenocidin, krimet kundër

njerëzimit dhe krimet e luftës të ish-regjimit shtetëror serb në Kosovë, më pas formimi i komisionit shtetëror për lansimin e tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë.

Pika të tjera të kësaj seance do të jenë: vendimi për ndërtimin e Muzeut të Gjenocidit tek ish-Tjegullorja, ndërtimi i Memorialit të Dëbimit të Stacioni Hekurudhor i Prishtinës si dhe caktimi i Ditës së Gjenocidit.

Një seancë e veçantë e Kuvendit do të mbahet më 21 maj për ta përkujtuar masakrën e Dubravës në 20-vjetorin e saj.



Ushtari i FSK-së, Liridon Selimi, zë vendin e dytë në garën ushtarake ndërkombëtare në Kroaci



Prishtinë, 13 maj (ER) - Në mesin e pjesëmarrësve nga trembëdhjetë shtete të botës, garues të Garës Ushtarake Ndërkombëtare në Republikën e Kroacisë, ushtaraku i Forcës së Sigurisë të Kosovës, tetar Liridon Selimi (Kompania e Operacioneve Civile) zuri vendin e dytë, duke u renditur pas ushtarakut rumun rreshter Mera Dorel Silviu si dhe duke lënë pas ushtarin amerikan William Hennesy. Konkursi i këtij viti është organizuar nga Komanda e Trajnimit dhe Doktrinës "Fran Krsto Frankopan" e ushtrisë tokësore kroate. Konkurrentët dhe pretendentët

nga tri kategori, një total prej 146 ushtarakësh, kanë zotëruar gjatësinë e përcaktuar të garës prej 40 kilometrave në kazermën "Josip Joviç" si dhe fushën e Krbavas.

Gara u zhvillua në fazën kualifikuese, pra gjuajtja kualifikuese me armë, që u mbajt më 9 maj 2019 si dhe gara kryesore ku, sipas planit, duhej të kalohej distanca prej 40 kilometrash, me 12 stacione punuese dhe tetë pika kontrolli.

Stacionet punuese në të cilat u sfiduan ushtarakët garues ishin: navigimi, hedhja e granatës, poligoni i kalitjes, gjuajtje me VHS

D2 (automatik), gjuajtje me HS-9 (pistoletë), gjetja e lokacionit në hartë, identifikimi dhe kontrolli i personit, ndihma e parë në fushëbetje, gjuajtja me AT-4 (antitank), kalimi i zonave të minuara dhe kontaminuara, kalimi i lumit mbi litar dhe thirrje për zjarr indirekt.

Kosova, përkatësisht ushtria e saj, në Garën Ushtarake Ndërkombëtare në Republikën e Kroacisë u përfaqësua nga dy ushtarakë të rinj, rreshter Lorik Ramaj dhe tetar Liridon Selimi, ku ky i fundit tregoi sukses të madh në garë duke fituar vendin e dytë.

Në UPZ u hap Biblioteka Austriake me mbi 2 000 tituj të librave

EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRIZREN, 13 MAJ - Në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren të hënën është bërë hapja e Bibliotekës Austriake (Këndit Austriak) me mbi 2 000 tituj të librave në gjuhën gjermane. Në hapjen solemne të bibliotekës kanë marrë pjesë ushtruesi i detyrës së rektorit të UPZ-së, prof. asoc. dr. Ismet Temaj, dekani i Fakultetit të Filologjisë, prof. asoc. dr. Shkëlqim Millaku, ambasadori i Austrisë në Kosovë, mag. Gernot Pfandler, lektorja në UPZ nga OeAD, mag. Martina Drescher, mag. Andreas Kurz, zyrtar i pro-

grameve në OeAD, mag. Peter Schinnerl, nga KFOR-i austriak si dhe profesorë e studentë të UPZ-së.

Me këtë rast ambasadori Pfandler ka theksuar se kjo bibliotekë është një sinjal për të gjithë studentët e rajonit të Prizrenit të cilët mësojnë gjermanishten dhe i ka falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuar për realizimin e suksesshëm të këtij projekti, duke uruar që kjo bibliotekë të jetë për shumë studentë dhe për shumë vite një vend ndihme dhe inspirimi.

Në veçanti ai ka falënderuar lektorën austriake Martina Drescher për punën e bërë në grumbullimin e këtyre librave



nëpër Austri, KFOR-in austriak për transportin dhe rektorin Temaj për mbështetjen e dhënë në hapjen e kësaj biblioteke në UPZ.

Ushtruesi i detyrës së rektorit Temaj ka theksuar se hapja e kësaj biblioteke është një lajm i mirë për studentët e UPZ-së, për realizimin e së cilës ka falënderuar ambasadorin

austriak, lektorën Drescher, KFOR-in austriak dhe të gjithë ata që kanë kontribuar. Ai ka shtuar se shteti dhe populli austriak kanë mbështetur shtetin dhe popullin e Kosovës në shumë aspekte, ndërsa hapja e kësaj biblioteke do të jetë një urë lidhëse mes studentëve e profesorëve të UPZ-së dhe Austrisë. Po ashtu, lektorja në UPZ nga OeAD, mag. Martina Drescher, mag. Andreas Kurz, zyrtar i programeve në OeAD dhe mag. Peter Schinnerl nga KFOR-i austriak përshëndetën hapjen e kësaj biblioteke dhe theksuan se për ata ka qenë një nder që kanë pasur mundësinë ta ndihmojnë UPZ-në dhe studentët e gjermanishtes.

ShKK-ja dhe Help Kosovo vazhdojnë bashkëpunimin

Prishtinë, 13 maj (ER) - Në kuadër të projektit "Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor 2019-2020", "Help Kosovo" ka mbështetur me pajisje për saldimit Qendrën Korrektuese në

Dubravë. Po ashtu, dymbëdhjetë të burgosur do të përfitojnë trajnim profesional për saldimit me ISO certifikim. Përmes këtij projekti synohet të ndikohet në rehabilitimin dhe risocializimin e personave të burgosur.

Qëllimi i përgjithshëm i programit është që t'i fuqizojë grupet e cenushme ekonomikisht dhe sociale, në këtë mënyrë të dënuar inkurajohen t'i mësojnë aftësitë e nevojshme profesionale të saldimit për t'i ndihmuar

ata që pas përfundimit të dënimit ta vazhdojnë punën si saldues. Me këto projekte, Shërbimi Korrektues i Kosovës synon t'i korrektojë dhe risocializojë të burgosurit duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa



marrë parasysh racën, gjuhën dhe religjionin.

Thaçi: Kuvendi i bashkuar duhet ta dënojë gjenocidin serb dhe të kërkojë drejtësi



Korishë, 13 maj (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të hënën ka marrë pjesë në tubimin përkujtimor kushtuar Ditës së Martirëve në fshatin Korishë. Presidenti Thaçi ka thënë se "sot kujtojmë me pietetin më të lartë, me respektin dhe nderimin më të lartë shtetëror, martirët e Korishës dhe fshatrave përreth që ranë para 20 vjetësh". "Gra, fëmijë e pleq, civilë shqiptarë, u vranë në rrethana që i imponoi shteti i Serbisë. Në rrethana që i detyruan të largohen nga shtëpitë e tyre, nga oborret e tyre, nga trojet e tyre dhe dhunshëm u ngarkuan në rimorkio të

zënë rob, për t'i bllokuar deri në çastin që ndodhi ajo që ndodhi", ka thënë presidenti Thaçi. I pari i vendit ka thënë se kjo masakër dhe martirët në Korishë janë viktima të gjenocidit të shtetit të Serbisë, të spastrimit etnik nga ana e shtetit të Serbisë. Ai ka thënë se është mirë që, më në fund, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka vendosur që në mënyrë të bashkuar të lëvizet përpara me nxjerrjen e një rezolute dhe dokumenteve të tjera pasuese, ku dënohet qartë gjenocidi i Serbisë i kryer në Kosovë dhe kërkohet drejtësi nga të gjitha instancat ndërkombëtare.

Mbi 57 mijë qytetarë me të drejtë vote për zgjedhjet lokale në veri

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar listën përfundimtare të votuesve me ç'rast është bërë me dije se rreth 58 mijë qytetarë kanë të drejtë vote për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të katër komunave në veri të vendit. Të drejtën e votës 57 983 qytetarët e katër komunave në veri mund ta shfrytëzojnë në 44 qendra të votimit, përkatësisht në 87 vendvotime



në 87 vendvotime. Në Komunën e Mitrovicës së Veriut janë 22 55 votues, shtatë qendra të votimit dhe 27 vendvo-

time. Ndërsa në Komunën e Leposaviqit janë 18 164 votues, tetëmbëdhjetë qendra të votimit dhe 31 vendvotime. Kurse në

Komunën e Zubin Potokut janë 8 535 votues, dymbëdhjetë qendra të votimit dhe 16 vendvotime. Ndërkaq në Komunën e Zveçanit janë 9 229 votues, shtatë qendra të votimit dhe 13 vendvotime. Ndërkohë të hënën ka filluar fushata pesëditore për zgjedhjet e së dielës në veri.

Gjatë kësaj periudhe subjektet politike kanë të drejtë të organizojnë tubime apo ngjarje politike, ose aktivitete të tjera të ngjashme, nëpërmjet të cilave synojnë përkrahjen e votuesve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka ftuar subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre, që t'u përmbahen ligjeve të Republikës së Kosovës dhe rregullave zgjedhore.

**EPOKA
ERE** **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 13 MAJ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në mbledhjen e së hënës ka certifikuar listën përfundimtare të votuesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të Komunës së Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Mitrovicës së Veriut.

Lista e aprovuar nga KQZ-ja përmban 57 983 qytetarë me të drejtë vote për zgjedhjet e jashtëzakonshme të 19 majit në veri. Në këto zgjedhje janë 970 votues më shumë krahasuar me zgjedhjet lokale të 22 tetorit të vitit 2017. Të drejtën e votës qytetarët e katër komunave në veri mund ta shfrytëzojnë në 44 qendra të votimit, përkatësisht

Rritet dyfish numri i koronarografive dhe stentimeve në QKUK

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 MAJ - Shërbimi i Kardiokirurgjisë me Kardiologji Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës ka rritur theksueshëm numrin e trajtimit të rasteve me probleme në zemër pas vendimit për shërbim 24 orësh nga shkurti i vitit të kaluar. Brenda tre muajve të parë të vitit 2019 mjekët specialistë kanë vendosur 507 stenta te pacientët, dyfish më shumë se në vitin 2018, i cili, për këtë periudhë kohore, arrinte në 285 sosh. Drejtori i Kardiokirurgjisë me Kardiologji Invazive, Tefik Bekteshi, pret që shifrat për rastet e intervenimeve të tilla të jenë më të mëdha këtë vit. Në vitin 2018 kardiologët kanë bërë

1 640 stentime. "Ka një progres të numrit të trajtimit të rasteve në këta tre muaj. Besoj se me këtë trend do t'i tejkalojmë numrat e vitit të kaluar nga aspekti i diagnostikës, domethënë angiografisë koronare, por edhe nga aspekti i stentimeve në infarkt akut të miokardit", ka thënë Bekteshi. Sipas raportit tremujor të punës për vitin 2019, në QKUK janë kryer edhe 719 koronarografi, kurse në vitin e shkuar 543. Kardiologu Bekteshi ka pohuar se listë klasike të pritjes për koronarografi nuk ka. Megjithatë, ai u tërheq vërejtjen mjekëve, të cilët, sipas tij, shpeshherë kërkojnë koronarografi pa nevojë dhe kështu zgjasin pritjet për pacientët. Me hapjen e sallës së dytë brenda



pak muajsh, Bekteshi shpreson që lista e pritjes të bjerë deri në tri javë. "Pritet të biem në nivel të pritjes më së shumti 15 deri në 20 ditë, duke potencuar se rastet

akute shkojnë përmes rrugës tjetër, përmes shërbimit të njësisë koronare, përmes Klinikës së Kardiologjisë", ka theksuar Bekteshi.

Në Klinikën e Kardiologjisë Invazive gjatë vitit 2017 janë vendosur 768 stenta për 651 pacientë, kurse janë realizuar 1 114 koronarografi.

Më 15 qershor hiqet roamingu ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë

PRISHTINË, 13 MAJ (ER) - Në kuadër të zbatimit të marrëveshjes për heqjen e çmimeve të shërbimeve roaming për rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, të nënshkruar në Pejë më 26.11.2018, ndërkaq më 11 maj 2019 në Tiranë u organizua mbledhja e përbashkët e Bordit Drejtues të ARKEP-it dhe Këshillit Drejtues të AKEP-it lidhur me procesin e reduktimit të tarifave dhe heqjes së plotë të

tyre për shërbimin roaming për qytetarët e Kosovës dhe Shqipërisë sipas kësaj marrëveshje.


Gjatë mbledhjes së mbajtur u diskutua për përfitimet që do t'i kenë qytetarët e të dy vendeve në lidhje me reduktimin dhe heqjen e plotë të tarifave të shërbimeve roaming, e cila do të aplikohet sipas principeve të modelit të aplikuar më parë nga vendet e Bashkimit Evropian "Roam Like At Home (RLAH)".

Në respektim të plotë të mar-

rëveshjes ndërshtetërore të dyja palët u pajtuan që procesi i reduktimit të tarifave të fillojë nga data 15 qershor 2019, fillimisht nëpërmjet aplikimit të modelit "RLAH+", reduktim i cili do të sjellë efekte pozitive të menjëhershme te qytetarët e të dy vendeve (nga kur do të ketë zvogëlim rreth 90 për qind nga kostoja aktuale e përdorimit të telefonisë në roaming), dhe në vijim heqjen e plotë të tarifave roaming për qytetarët e dy vendeve, duke filluar nga 1 korriku 2021.



Matoshi kërkon angazhim më të madh nga kompanitë regjionale të mbeturinave



PRISHTINË, 13 MAJ (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, është takuar me anëtarët e Pamkos-it, Asociacion i Kompanive Regjionale të Mbeturinave të Republikës së Kosovës, në kuadër të së cilës hyjnë KRM "Pastrimi" - Prishtinë, KRM "Ambienti" - Pejë, KRM "Ekoregjioni" - Prizren, KRM "Çabrat" - Gjakovë, KRM "Ecohigjiena" -

Gjilan, KRM "Pastërtia" - Ferizaj dhe KRM "Uniteti" - Mitrovicë. Gjatë këtij takimi ministri Matoshi dhe anëtarët e Pamkos-it kanë diskutuar për sfidat që kanë kompanitë regjionale të mbeturinave, si ato teknike ashtu edhe ato ligjore, dhe zgjedhjen e tyre nëpërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës. Me këtë rast, ministri Matoshi ofroi mbështetje për këto kompani aksionare, duke i

vlerësuar si partneret kryesore të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. "Kompanitë që ju drejtoni janë të rëndësishme për ministrinë që e drejtoj dhe vendin tonë. E di që keni sfida dhe bashkërisht do të përipiqemi t'i tejkalojmë. Për t'i kaluar këto sfida propozoj ta bëjmë një grup punues të përbashkët dhe t'i hedhim në letër të gjitha kërkesat tuaja", ka thënë ministri Matoshi.

I pari i MMPH-së kërkoi nga përfaqësuesit e kompanive regjionale të mbeturinave që t'i evidentojnë dhe raportojnë keqpërdoruesit e mjedisit si dhe të shikohet mundësia përmes komunave që përfaqësuesit e tyre të kenë të drejtë të japin gjoba mandatore për ata që hedhin mbeturina në vende të palejuara. Ministri Matoshi tregoi për veprimet që janë ndërmarrë për

menaxhimin e mbeturinave nga MMPH-ja. "Ne e kemi pasur aksionin 'Ta pastrojmë Kosovën', i cili ka pasur qëllim të arrihet vetëdijesimi i qytetarëve për hedhje të mbeturinave në vende të palejueshme dhe besoj se ia kemi arritur. Si ministri e kemi një grand prej 7 milionë eurosh, ku 3.5 janë nga MMPH-ja dhe 3.5 nga GIZ-i gjerman për menaxhim të mbeturinave. Po ashtu, së fundmi kemi ndarë kontejnerë për komuna. Kemi pasur, po ashtu, një grant nga JICA japoneze për shpërndarje të kamionëve", tregoi ministri Matoshi.

Ndër të tjera, ministri Matoshi tregoi se MMPH-ja është në proces të procedurave ligjore të Strategjisë për Menaxhim të Mbeturinave si dhe ka miratuar Udhëzimin për Gjoba Mandatore që do t'i kontribuojë një mjedisi pa mbeturina.

Ndërsa anëtarët e Pamkos-it gjatë këtij takimi kanë treguar për sfidat që hasin Kompanitë Regjionale të Mbeturinave të Republikës së Kosovës, duke filluar nga borxhet e akumuluar, mungesa e pajisjeve të reja për grumbullim të mbeturinave, kamata e ndëshkimit nga ATK-ja, deponitë ilegale dhe sfidat për menaxhimin e mbeturinave.

Kosova dhe Turqia shtojnë bashkëpunimin në bujqësi

Prishtinë, 13 maj (ER) - Kosova dhe Turqia do ta zgjerojnë bashkëpunimin në fushën e zhvillimit ekonomik, në veçanti në sektorin e bujqësisë. Përkrahja e këtij shteti në fushën e bujqësisë do të rritet në vazhdimësi. Kështu u tha të hënën gjatë takimit që ministrja e MBPZHR-së, Dijana Ziviq, pati me ambasadorin e Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar, si dhe me sekretarin e thesarit të

ambasadës, Onur Tanay dhe koordinatorin e T?KA-s, Burak Ceran.

Gjatë këtij takimi është diskutuar rreth mundësive për bashkëpunim të mëtejshëm në sektorët që mbulojnë nga MBPZHR-ja, me qëllim të fuqizimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të bujqësisë në gjithë vendin.

Ministrja Ziviq ka falënderuar ambasadorin e Turqisë për viz-

itën dhe me këtë rast e ka njoftuar edhe me programet zhvillimore të ministrisë për fermerët dhe agrobizneset. Në anën tjetër, ambasadori Çagri Sakar e falënderoi ministrën Ziviq për pritjen dhe informimin rreth gjendjes në sektorin e bujqësisë dhe theksoi se do t'u shohin mundësitë e bashkëpunimit në këtë sektor, me qëllim të realizimit të projekteve të ndryshme bujqësore.



Udhëheqësit e arsimit profesional të Iowas vizitojnë Qendrën e Trajnimeve të KEK-ut



Udhëheqësit e arsimit profesional të Iowas kanë vizituar të hënën Qendrën e Trajnimeve të KEK-ut, ku janë pritur nga drejtori ekzekutiv i Shërbimeve të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Edmond Nulleshi, me bashkëpunëtorë. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë për t'u njohur me mundësitë që ofron KEK-u me Qendrën e Trajnimeve profesionale për përgatitjen e të rinjve për tregun e punës

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 13 MAJ - Drejtori ekzekutiv i Shërbimeve të Korporatës Energjetike të Kosovës, (KEK), Edmond Nulleshi, me bashkëpunëtorë, ka pritur të hënën në një takim Robert J. Denson, president i DMACC (rrjeti i kolegjeve profesionale) nga shteti Iowas të

Shteteve të Bashkuara, si dhe zëvendës-presidentin Scott J. Ocken. DMACC konsiderohet si një nga institucionet më të mira arsimore profesionale në Iowa.

Qëllimi i kësaj vizite ka qenë për t'u njohur nga afër me mundësitë që ofron KEK-u me Qendrën e Trajnimeve profesionale për përgatitjen e të rinjve për tregun e punës, si

dhe për mundësinë e bashkëpunimit të dy institucioneve arsimore në të ardhmen. Fillimisht Nulleshi i ka falënderuar Densonin dhe Ockenun për gatishmërinë që kanë treguar për ta vizituar KEK-un, respektivisht Qendrën e Trajnimeve. Gjithashtu, u ka shpjeguar mysafirëve edhe për historikun e saj. "Objekti i Qendrës së Trajnimeve ka një

sipërfaqe të brendshme prej 1572 m². Është e pajisur me laboratorë, salla të trajnimeve, punëtori dhe me të gjitha pajisjet e nevojshme. Me trajnerë profesionalë për mbajtje të trajnimeve për pjesën teorike dhe pjesën praktike, të cilët janë të certifikuar me standarde ndërkombëtare. Për më tepër, të gjitha programet janë të certifikuara me standarde ISO", ka thënë Nulleshi.

Më pas stafi i Qendrës Trajnuese ka prezantuar të gjitha programet me të cilat është e certifikuar kjo qendër. Ndërkaq presidenti Denson është ndarë shumë i kënaqur me pritjen dhe prezantimin e kapaciteteve që ka kjo qendër si dhe me prezan-

timin nga menaxhmenti dhe trajnuesit profesionalë të KEK-ut. "Vizita në Qendrën Trajnuese të KEK-ut ka qenë shumë interesante dhe nga më impresionueset që kemi pasur në Kosovë. Ky është një institucion shumë i rëndësishëm dhe një mundësi e mirë për kandidatët e interesuar që t'i ndjekin trajnimet dhe të përfitojnë nga kjo mundësi në mënyrë që të pajisen me njohuri për këto drejtime specifike. Është shumë e rëndësishme që kandidatët pajisen edhe me certifikata të njohura ndërkombëtare dhe shpresojmë që në të ardhmen të kemi bashkëpunim mes dy institucioneve arsimore", ka potencuar Densoni.

Mundësi punësimi dhe trajnimi për më shumë se 240 punëkërkues

PRISHTINË, 13 MAJ (ER) - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) fton të gjithë punëkërkuesit e papunë, të regjistruar në Zyrat e Punësimit në të gjitha komunat e Kosovës, që të aplikojnë në kuadër të Programit të Subvencionimit në Pagë dhe Trajnimit në Punë. Njëpërmjet Programit të Subvencionimit në Pagë dhe

Trajnimit në Punë do të mbështeten mbi 240 punëkërkues të papunë, me fokus punëkërkuesit afatgjatë që hasin vështirësi për t'u trajnuar dhe punësuar.

Krijimi i mundësive për punësim për punëkërkuesit në Kosovë, duke subvencionuar punëdhënësit të cilët janë të gatshëm t'i punësojnë ata në periudha afatgjata si dhe ofrimi i mundësisë së trajnimit për punëkërkuesit e papunësuar që kanë nivel të ulët arsimor dhe nuk kanë

përvojë të mëparshme të punës, janë objektivat e këtyre dy skemave.

Afati i aplikimit është i hapur nga data 14 deri më 24 maj 2019. Ftojme punëkërkuesit që t'i vizitojnë zyrat e punësimit për më shumë informacione rreth procedurave të aplikimit, apo t'i shfletojnë uebfaqet: www.mpms.rks-gov.net dhe <http://apr.k.rks-gov.net>, ku mund të shkarkohen formularët e aplikimit të cilët duhet të dorëzohen pranë Zyrës së Punësimit në komunën tuaj.





'Jetimat e Ballkanit' dhe Komuna e Malishevës nënshkruan marrëveshje për ndërtimin e pesë shtëpive

MALISHEVË, 13 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dhe udhëheqësi i Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", Halil Kastrati, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi për ndërtimin edhe të pesë shtëpive për familjet me kushte të rënda ekonomike dhe sociale.

Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar, Shoqata "Jetimat e Ballkanit" do ta zbatojë projek-

tin e ndërtimit të shtëpive, sipas programit çelësar në dorë, ndërsa mjetet do të jenë në bashkëfinancim me komunën, ku Shoqata "Jetimat e Ballkanit" merr pjesë me shumën prej 75 përqindësh, ndërsa Komuna e Malishevës me shumën prej 25 përqindësh. Ndërtimi i shtëpive, bazuar në marrëveshjen e nënshkruar, do të bëhet brenda vitit 2019. Kjo marrëveshje është bërë në kuadër të bashkëpunimit të mirë në mes


të Komunës së Malishevës dhe Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit" dhe është vazhdim i ndërtimit të përbashkët të shtëpive për familjet në nevojë në Komunën e Malishevës. Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, e ka falënderuar Halil Kastratin dhe Shoqatën "Jetimat e Ballkanit" për angazhimin e tyre për ofrimin e ndihmës për rastet në nevojë në Komunën e Malishevës.

Në Mitrovicë evidentohen zona natyrore me potencial për regjistrin e zonave të mbrojtura

Mitrovicë, 13 maj (ER) - Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, në kuadër të detyrave programore të tij, në bashkëpunim me Komunën e Mitrovicës, ka realizuar projektin e evidentimit të vlerave natyrore në këtë komunë.

Gjatë këtij hulumtimi janë evidentuar disa zona me vlera natyrore, të karakterit botanik, hidrologjik dhe speleologjik, që dallohen me karakteristikë të veçanta në territorin e Komunës së Mitrovicës.

Vlerat e identifikuar që kanë plotësuar kriteret për t'u marrë në mbrojtjen ligjore janë: Trungjet e Ahut (*Fagus sylvatica*) në fshatin Bajgorë; Trungjet e Ahut (*Fagus sylvatica*) në fshatin Bajgorë; Trungju i Ahut (*Fagus*



sylvatica) në fshatin Bare; Shpellat e Kaçandollit në fshatin Kaçandoll; Burimi i ujit mineral në fshatin Mazhiq; Ujëvara e trapçalive në fshatin Melenicë; Trungju i Ahut (*Fagus sylvatica*) me Burimin e ujit nën rrënjë, në fshatin Ovçar; Kroni i Akullit në

fshatin Rahovë; Ahishtat e Llomovës në fshatin Selac; Trungjet e Qarrit (*Quercus cerris*) në fshatin Zabërgjë; Trungju i Ahut (*Fagus sylvatica*) në fshatin Zabërgjë; Trungju i Qarrit (*Quercus cerris*) në fshatin Zabërgjë.

Përkujtohen dëshmorët Tahir e Nebih Meha në 38-vjetorin e rënies së tyre

SKENDERAJ, 13 MAJ (ER) - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, është mbajtur një akademi përkujtimore për nder të përvjetorit të 38-të të rënies së dëshmorëve Nebih e Tahir Mehës. Para se të mbahet kjo akademi, Jashari ka bërë homazhe te varret e dëshmorëve Nebih e Tahir Meha në lagjen "Mehaj" në Prekaz. Në homazhe dhe akademi, përpos Jasharit, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, familjarë të dëshmorëve, invalidë dhe veteranë, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, qytetarë etj.

Kryetari Jashari në fjalën e tij ka theksuar se janë duke përkujtuar me mirësi dhe respekt dëshmorët e kombit, luftëtarët e etapave të ndryshme të historisë shqiptare, që luftuan me çfarëdo që kishin kundrejt një force shkatërrimtare, siç ishte armiku ynë. "Vuajtjet e popullit shqiptar janë të kahershme. Sa herë ishin të lehta e sa herë të rënda, por prapëseprapë ishin vuajtje", ka theksuar kryetari Jashari, duke shtuar se këto vuajtje populli shqiptar nuk do t'i duronte në pafundësi dhe gjithmonë ishte i gatshëm t'u japë fund edhe atëherë kur çmimi ishte tepër i lartë. "Populli shqiptar i Kosovës i kishte rezistuar për vite me radhë shtypjes së egër nga pushtuesi serb, por qëndresa heroike e


Tahir dhe Nebih Mehës do ta shënonte rezistencën aktive me armë në duar kundër pushtuesit jugosllav të trojeve tona", ka thënë Jashari.

Ai ka thënë se 38 vjet më parë Kulla e Mehajve ishte gjendur e rrethuar nga milicia serbe që për detyrë kishite arrestimin e të pabindurit Tahir Meha. "Ajo që njihej në atë kohë si 'Dita e Milicisë', vërtet doli të jetë e tillë, madje u doli për hundësh aksioni i arrestimit, pasi përreth kullës së rezistencës kishin mbetur të vdekur disa milicë serbë. "Në përpjekje për ta çarë rrethimin, meqë po iu mbaronte municioni, kishin rënë në altarin e lirisë, babë e djalë, Nebih dhe Tahir Meha, duke shkruar kështu një faqe të veçantë të heroizmit dhe sakrificës së popullit shqiptar për liri dhe pavarësi nga okupatori jugosllav", ka thënë Jashari, duke shtuar se në ditën e varrimit të Tahir dhe Nebih Mehës, Shaban Jashari me dy djemtë e tij, Ademin dhe Hamzën, ishin zotuar se krismat e pushkës nuk do të ndalen deri në çlirimin përfundimtar të Kosovës nga okupatori serb. Në këtë akademi janë përkujtuar edhe dëshmorët e tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si Malush Ahmeti dhe 31 dëshmorë të tjerë të kombit. Dëshmorët Tahir dhe Nebih Meha janë përkujtuar edhe nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi.



Vazhdon shenjzimi i rrugëve në Malishevë

MALISHEVË, 13 MAJ (ER) - Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Malishevës, Milazim Morina, ka bërë me dije se është duke vazhduar realizimin e projektit për shenjzimin e rrugëve dhe parkingjeve në këtë komunë. Ai ka thënë se këto ditë ka përfunduar edhe vendosja e vijave të bardha në fshatin Berishë. "Kemi shenjzuar edhe parkingjet në qytet dhe në oborret e institucioneve në qytetin e



Malishevës janë vendosur shenjat e parkimit të veturave për personat me aftësi të veçanta me qëllim që t'u rezervohet vendparkimi i veturave", ka thënë drejtori Morina.

Ballkani Perëndimor, ne besojmë te biznesi!

"I ndodhur në kryqëzimin midis Lindjes dhe Perëndimit, rajoni mund të shërbejë si një port i sigurt për investimet, ndërkohë që mundëson qasje të lehtë në tregun botëror"



Nga Majlinda BREGU,
*Sekretare e Përgjithshme
e Këshillit të
Bashkëpunimit Rajonal
(RCC)*

Ballkani Perëndimor mund të jetë fole e shumë problemeve, por perceptimi i biznesit mbetet gjerësisht pozitiv në një masë prej 61 pikësh. Por, nëse e shohim rajonin në një "panoramë të plotë", duhet t'i hedhim sytë drejt një shifre tjetër: 63 për qind e qytetarëve të Ballkanit Perëndimor janë të pakënaqur me gjendjen ekonomike. Është e thjeshtë t'i vësh re shenjat e rrëmujës kur flasim për: sundimin e ligjit, angazhimin e zyrtarëve publikë për të kuptuar dhe zgjidhur problematikat dhe mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me biznesin, ndërkombëtarizimin e sektorëve privatë të rajonit për

të arritur nivele më të larta investimesh ndër-rajonale dhe ndërkombëtare dhe për të stimuluar shkëmbime më të vrullshme tregtare, shkallën e papunësisë që qëndron në nivele dyshifrore dhe largimin e trurit që po merr përmasa më të mëdha. Dhe këto janë vetëm disa prej këtyre shenjave. Por një e vërtetë thelbësore humbet midis hiperbolës dhe të vërtetës. Më shumë se gjysma e qytetarëve të Ballkanit Perëndimor besojnë se perspektiva evropiane do ta përmirësojë jetën e tyre, se ajo do t'i forcojë lidhjet ekonomike midis gjashtë ekonomive të Ballkanit Perëndimor.

Sipas matjeve dërrmuese objektive, përgjatë viteve të shkuara rajoni ka përjetuar një rritje të pandërprerë ekonomike (tendenca është për 3.5 për qind në vitin 2019 dhe 3.8 për qind në vitin 2020). E, megjithatë, PBB-ja për frymë në Ballkanin Perëndimor është më e ulët se një e treta e PBB-së së Gjermanisë, si vendi më i pasur anëtar i BE-së, dhe stoku mesatar i Investimeve të Huaja Direkte (FDI) për frymë në Ballkanin Perëndimor është më i ulët se gjysma e stokut të FDI-së për frymë në vendet anëtare të BE-së nga Evropa Lindore dhe vetëm sa një e shtata e mesa-

tares së BE-së.

Gjithsesi, rajoni ofron një mjedis mikpritës për investimet, duke prezantuar nivele tatimi të fitimit për korporatat që variojnë nga 9 për qind në 15 për qind, nivele të cilat janë nga më të ulëtat në Evropë. Sistemet monetare dhe financiare në rajon kanë një varësi të madhe nga Euro-ja. Një nga asetet më të mëdha të rajonit janë burimet njerëzore, duke qenë se në vitet e fundit fuqisë punëtore i janë shtuar më shumë se 1.6 milion individë tejet të kualifikuar. Për më tepër, rajoni i Ballkanit Perëndimor është një treg lokal me shumë kërkesa. Marrëveshja e brendshme e tregtisë së lirë në rajon u siguron qasje të drejtpërdrejtë rreth 20 milionë konsumatorëve.

Ky rajon duhet të përfshihet në një qasje të përbashkët proaktive për përmirësimin e mjedisit të vet të biznesit dhe t'ia demonstrojë këtë qasje komunitetit botëror të biznesit.

I ndodhur në kryqëzimin midis Lindjes dhe Perëndimit, duke pasur një rrjet marrëveshjes tregtie të lirë dhe me statusin preferencial të tregtisë me ekonomi të treta (BE, ShBA, vendet e EFTA-s, Turqi, Rusi dhe vendet e ish-Republikës Ruse), rajoni mund të shërbejë si një port i sigurt për investimet, ndërkohë që mundëson qasje të lehtë në tregun botëror.

Investitorët e huaj i kanë identifikuar tashmë mundësitë e pranishme në Ballkanin Perëndimor dhe kështu, rajoni ka regjistruar një fluks hyrës investimesh të huaja direkte prej 1 miliard eurosh gjatë vitit të

kaluar. Megjithatë, mençuria konvencionale flet qartë: këto mbeten ende shifra modeste dhe janë shumë poshtë potencialit të vërtetë të Ballkanit Perëndimor.

Çelësi është konektiviteti. Konektiviteti i tregjeve, individëve, integrimi i 6-shes të Ballkanit Perëndimor në tregun e bashkuar të BE-së. Kjo është logjika që qëndron në themel të Zonës Ekonomike Rajonale të Ballkanit Perëndimor (REA). REA synon lëvizjen e mallrave, shërbimeve, investimeve, komunitetit të biznesit dhe fuqisë së aftë punëtore midis 6 ekonomive.

Në kuadër të këtij aksioni, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) ka sjellë së bashku qeveritë dhe bizneset e rajonit për të punuar për mundësimin e lëvizjes së lirë të investimeve, kapitalit njerëzor dhe komunikimit, rezultatet e të cilave do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë tek biznesi dhe cilësia e jetës së qytetarëve tanë. Pa qenë nevoja që të përmendim ndikimet horizontale që puna jonë ka pasur mbi potencialet e pashfrytëzuara të rajonit tonë, të tilla si baza e SME-ve, baza industriale, zhvillimi i zinxhirëve rajonalë të vlerave dhe përfshirja e tyre në zinxhirët botërorë të vlerave si dhe rritja e punësimit për gratë dhe të rinjtë.

Bizneset e rajonit na mbështesin në këtë mendësi, dhe thuajse 70 për qind e tyre shprehen se bashkëpunimi rajonal është i rëndësishëm për aktivitetin e tyre të biznesit.

Deri tani, nën ombrellën e REA-s dhe me mbështetjen e rajonit

dhe të BE-së në rrugën tonë, kemi: - Arritur një marrëveshje historike rajonale për eliminimin e kostove të roaming-ut dhe kemi hapur rrugën për një ulje më të qenësishme të kostove të roaming-ut midis Ballkanit Perëndimor dhe BE-së. Për bizneset dhe qytetarët tanë kjo përfaqëson një arritje të madhe në zhvillimin e një tregu të hapur rajonal. - Hapur negociatat për një marrëveshje rajonale që do të mundësojë krijimin e një grupi rajonal ekspertësh që mund të lëvizin nëpër rajon si dhe do të lehtësojë lëvizjen e lirë të kapitalit njerëzor në rajon, përkatësisht përmes njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale në sektorët e mjekësisë dhe inxhinierisë së ndërtimit, dhe njohjen e kualifikimeve akademike të fituara në institucione të arsimit të lartë me cilësi të garantuar. - Lehtësuar agjendën e parë të përbashkët të investimeve për rajonin, duke krijuar një hapësirë të përbashkët investimi dhe reformash në fushat e hyrjes së investimeve dhe mbrojtjes së tyre, si dhe promovimin e rajonit tek komuniteti botëror i biznesit si një destinacion i përshtatshëm për investime. Punës së bërë po i shtojmë më tej vlerë duke nisur reforma në sektorin financiar për të mundësuar qasje në më shumë mundësi financimi për zhvillimin e biznesit. Kjo është një sipërmarrje ambicioze dhe, pa dyshim, nuk është i vetmi aktivitet në planin e punës të RCC-së, por ne jemi tejet të ndërgjegjshëm se pajtimi ekonomik i rajonit do ta përforcojë prosperitetin e përbashkët.

Këshilli Prokurorial, i përkushtuar për luftimin e dhunës në baza gjinore

PRISHTINË, 13 MAJ (ER) - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial (KPK), Bahri Hyseni, ka pritur në takim përfaqësueset e Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), Adelina Berisha, e cila është koordinatore për avokim kundër dhunës ndaj gruas dhe Klarista Fetahun, koordinatore e Projektit "UNWoman". Me këtë rast, kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Bahri Hyseni, ka theksuar nevojën e fuqizimit të bashkëpunimit me Rrjetin e Grave të Kosovës në kuadër të iniciativave dhe evenimenteve të ndryshme vjetore, të cilat organizohen nga të dyja palët, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në avancimin dhe fuqizimin e rolit të institucioneve në luftimin e dhunës në familje dhe cenimin e barazisë gjinore në Kosovë. "Bashkëpunimi me Rrjetin e Grave të Kosovës do të

vazhdojë në të ardhmen me dinamikën e evidentuar në aktet strategjike, sidomos pas ndryshimeve ligjore, ngaqë sistemi prokurorial do të ketë një përkushtim të veçantë për luftimin e çfarëdo forme të shprehur të dhunës ndaj grave dhe rasteve të dhunës në baza gjinore në Kosovë", ka thënë Kryesuesi Hyseni.

Nga ana tjetër, përfaqësuesja e RrGK-së, Adelina Berisha, ka njoftuar kryesuesin e KPK-së, Bahri Hyseni, për publikimin e një hulumtimi të veçantë, i cili është nxjerrë me rastin e monitorimit të reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore me titull: "Nga fjalët në vepra?", duke kërkuar njëherësh që Këshilli të dërgojë një prokuror në ekspozitën "Përmirësimi i qasjes në shërbimet për gratë", e cila pritet të mbahet brenda



këtë muaji, për t'iu përgjigjur pyetjeve të qytetarëve, si dhe që kjo ekspozitë të hapet në secilën prokurori të vendit. Kjo ekspozitë ka për qëllim ta

promovojë rolin e institucioneve në mbrojtjen e të drejtave të grave dhe raportimit të dhunës në baza gjinore. Të dyja palët u pajtuan që të punojnë së bashku

në çështjet e ndërsjella, me ç'rast do të dalë në pah raportimi i rregullt ndër-institucional i dhunës ndaj gruas dhe rasteve të dhunës në baza gjinore.

ShBA-ja paralajmëron për tensione të shtuara në Irak

BAGDAD, 13 MAJ - Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Bagdad lëshoi një alarm të sigurisë për qytetarët amerikanë, duke i paralajmëruar për tensione të shtuara në Irak dhe kundër udhëtimit në këtë vend. Paralajmërimi vjen në kohën e tensioneve në rritje midis Iranit fqinj dhe Shteteve të Bashkuara. Ambasada amerikane nuk dha

detaje për natyrën e kërcënimeve. Javën e kaluar, sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, realizoi një vizitë të papritur në Bagdad. Vizita u bë pasi Uashingtoni dërgoi një aeroplanmbajtëse dhe një forcë bombarduese në Lindje të Mesme, gjë të cilën zyrtarët amerikanë e përshkruan si përgjigje ndaj kërcënimeve të Iranit.

"Në rast se Irani vendos t'iu kundërvihet interesave amerikanë - qofshin ata në Irak, Afganistan, Jemen apo kudo në Lindjen e Mesme, ne jemi të gatshëm të përgjigemi në mënyrën e duhur", tha Pompeo në një intervistë për televizionin CNBC. "Qëllimi ynë nuk është lufta", shtoi ai.



Sekretari i Shtetit Mike Pompeo nis turneun evropian

Sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo shkoi të hënën në selinë e Bashkimit Evropian në Bruksel ku do të takohet me aleatët evropianë për të diskutuar mbi veprimet dhe deklaratat kërcënuese të Republikës Islamike të Iranit kohët e fundit"

UASHINGTON, 13 MAJ - Sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo shkoi të hënën në selinë e Bashkimit Evropian në Bruksel, ndalesa e parë e udhëtimit të tij evropian.

Zëdhënësja e Departamentit të Shtetit Morgan Ortagus tha të hënën se Mike Pompeo do të takohet me aleatët evropianë në Belgjikë "për të diskutuar mbi veprimet dhe deklaratat kërcënuese të Republikës Islamike të Iranit kohët e fundit". Zëdhënësja shtoi se Sekretari i Shtetit "do të vazhdojë të koordinojë ngushtë me aleatët dhe partnerët tanë, me synimin që interesat e përbashkëta në Lindjen e Mesme dhe në mbarë botën të jenë të sigurta".

Fillimisht Sekretari Pompeo kishte planifikuar të takohej të hënën me diplomatët amerikanë

dhe udhëheqësit e biznesit në Moskë, ka njoftuar vora.

Pati një ndryshim të planeve të tij të dielën vonë dhe në vend të kësaj, ai ndaloi së pari në Belgjikë. Planet për pjesën tjetër të udhëtimit të diplomatit të lartë amerikan mbeten të pandryshuara.

Sekretari Pompeo shkon sot (e martë) në Soçi për të biseduar me presidentin e Rusisë Vladimir Putin dhe me ministrin e Jashtëm Sergej Lavrov.

Udhëtimi i Mike Pompeo vjen disa javë para një takimi të nivelit të lartë të G-20 në Osaka, të Japonisë, ku do të marrë pjesë edhe presidenti amerikan Donald Trump dhe presidenti rus Vladimir Putin.

Udhëtimi i Pompeo në Rusi ndodh në mesin e tensioneve mes të dy vendeve mbi Iranin.



Shtetet e Bashkuara po e forcojnë praninë ushtarake në Lindjen e Mesme, në atë që zyrtarët thanë se ishte një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj një numri treguesish dhe paralajmëruesish shqetësues nga Irani.

Aeroplanmbajtësja USS

Abraham Lincoln me një grup avionësh dhe katër bombardues të B-52 kanë mbërritur tashmë në Lindjen e Mesme, në përgjigje të shqetësimeve që Irani mund të planifikojë një sulm kundër objektivave amerikane.

Të mërkurën e kaluar ministri i

Jashtëm rus Lavrov i kërkoi Sekretarit Pompeo të përdorte diplomacinë në vend të kërcënimeve, për të zgjidhur çështjet, pas bisedimeve të Lavrovit me ministrin e Jashtëm iranian Mohammad Javad Zarifin në Moskë.

Euro-skeptikët kryesojnë në sondazhe



BRUKSEL, 13 MAJ - Dy javë nga zgjedhjet për Parlamentin Evropian, shqetësimi më i madh i unionit mbetet rritja e ndjeshme e rrymës euro-skeptike. Rasti më i fundit vjen nga Britania e Madhe, e detyruar të hyjë në zgjedhje pas dështimit të afatit për Brexit.

Sipas një sondazhi të publikuar nga "The Guardian", Partia e Brexit e eurodeputetit Farage pritet të marrë në votimet e 26

majit, 34 vende në PE, më shumë se dy partitë e mëdha britanike të marra së bashku.

Opozitarët laburistë nuk do të fitojnë më shumë se 21 euro-deputetë. Ndërsa pasiguritë që kanë rrethuar kryeministrin May rreth shkëputjes së vendit nga BE-ja, shfaqin pasojat e para. Partia Konservatore pritet të sigurojë 11 vende në Parlamentin Evropian.

Shefja e Qeverisë britanike

dështoi të përmbyllë Brexitin në afatin e parë dhe mori një shtyrje deri më 31 tetor nga BE-ja, çka ka ulur ndjeshëm mbështetjen e saj në popull.

Me bisedimet për Brexit në buzë të kolapsit, bashkëpunëtorët e ngushtë kanë këshilluar May të pranojë çdo marrëveshje me laburistët, përfshirë edhe referendumin e dytë, që kryeministrja e konsideron si vijën e saj të kuqe.

Në një hotel në Gjermani 3 persona gjenden të vdekur

BERLIN, 13 MAJ - Policia gjermane ka konfirmuar se janë duke hetuar vdekjen e tre personave, trupat e të cilëve u gjetën me shigjeta harku në një dhomë hoteli në Bavari.

Agjencia gjermane e lajmeve DPA njoftoi se punonjësit e

hotelit në qytetin Passau gjetën trupat dhe dy harqe në dhomë. Policia tha se tre viktimat, të cilat u gjetën të shtunën, ishin një burrë 53 vjeç dhe dy gra të moshës 33 dhe 30 vjeç, të gjithë shtetas gjermanë.

Ata theksuan se nuk është e qartë

se cila ishte marrëdhënia e tyre dhe nuk dihet çfarë ndodhi brenda dhomës së hotelit ose se si saktësisht vdiqën të tre. Prokurorët kanë urdhëruar një autopsi dhe kanë nisur hetimet për të zbardhur ngjarjen që tronditi vendin.





BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



E jashtëzakonshme

Fatura që po 'çmend' rrjetet sociale: dy hamburgerë dhe dy kapuçino, 81 euro

Dy hamburgerë dhe dy kapuçino, nën hijen e kupolës së San Pietros, për 81 euro dhe rasti përfundon në rrjetet sociale. Kjo faturë është paguar nga dy turistë në zonën rreth Vatikanit në Romë. Kjo faturë tashmë ka ndezur indignatën, por edhe ironinë në rrjetin social "Facebook". Fast-food ka shpjeguar për "Il



Messaggero". "Klientët zgjodhën nga menyja dhe aty ishin të vendosura çmimet. Ata e dinin se ç'po hanin dhe sa duhet të paguanin për këtë".

FOTO E DITES



Një lepur shihet duke kaluar nëpër një fermë në Frankfurt të Gjermanisë. /AP/

E rrallë

Luani fillon terapinë për kancerin e lëkurës në një spital për njerëzit

Një luan po merr trajtim për kancerin e lëkurës në një spital për njerëzit në Afrikën e Jugut. Luani 16-vjeçar me emrin 'Kaos' ka hyrë në spitalin privat nga dera e pasme për të mos u frikësuar nga njerëzit. Luani 258 kilogramë u trajtua nga një



ekip prej pesë radioterapistë dhe një onkolog në një mjedis të pazakontë pasi nuk ka objekte të rrezatimit për kafshët në Afrikën e Jugut.

BARSOLETA E DITËS



- Qëkur jam shkukurëzuar nuk po e bëj më gjumin rehat!
- Pse, aq shumë të mungon?
- Jo more burrë, po ma mori krevatin plehra.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

"DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



Ne ora 16:00 dhe 19:00

"AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

"EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



16.05.2019

"THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Një ditë jo e mirë. Po kuptoni që keni debatuar me kot me një person që do vetëm të mirën tuaj.</p>	 <p>DEMI Jeni pak në ankth sot dhe nuk po e kuptoni nga ju vjen. Dita nuk do të jetë e qetë sepse shumë mendime po jua turbullojnë mendjen.</p>	 <p>BINJAKËT Duhet të sqaroni sa më parë një keqkuptim të lindur sepse duke e neglizhuar do të thellohen më shumë mosmarrëveshjet.</p>	 <p>GAFORRJA Po mundoheni të ambientoheni me të rejtat e fundit që po ju ndodhin. Edhe pse ka shumë rrëmujë rreth e qark jush, do të arrini ta gjeni oazën tuaj.</p>	 <p>LUANI Nuk është se keni ndryshuar mendim lidhur me një person të caktuar, por disa situata të reja ju kanë bërë më dyshues dhe më të vëmendshëm.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Jeni të fokusuar te familja sot dhe doni t'ua plotësoni pjesëtarëve të saj çdo dëshirë që ju kanë shprehur. Kjo gjë ju lumturon pa fund.</p>
 <p>PESHORJA Pak lëvizje në jetën në çift nuk bën aspak keq, madje është mënyra për ta shijuar më mirë marrëdhënien. Do</p>	 <p>AKREPI Sot jeni zgjuar me humor të keq dhe karakteri juaj nuk</p>	 <p>do të jetë i thjeshtë për t'u duruar përgjatë orëve të ditës. SHIGJETARI</p>	 <p>Do të merrni sinjale që fillimi i ditës do të jetë i mbushur me ndryshime dhe surpriza. Duhet të filloni që tani të ambientoheni.</p>	 <p>BRICJAPI Nuk është se sot planetët do të jenë në rrugën tuaj. Shumë herë do të keni çaste tensioni gjatë ditës që do t'ju</p>	 <p>UJORI Edhe pse në çaste të caktuara të ditës pozitativat tuaja do të lëkundin ndjeshëm, jeni</p>

Jhene Aiko kalon kohë me ish të dashurin



Jhene Aiko ka kaluar kohë me ish të dashurin e saj, Big Sean. Këngëtarja 31-vjeçare hyri të shtunën në "Instagram" për të ndarë një fotografi teksa shihet bashkë me reperin duke buzëqeshur. "Sot ishte një ditë e

mirë", ka shkruar Jhene. Jhene dhe Sean ishin në lidhje që nga viti 2016 deri në fund të vitit 2018. Në fillim të kësaj jave Jhene lëshoi këngën e re me titull "Triggered" për të cilën fansat mendojnë se ia kushtoi ish të dashurit.

Angelina Jolie e lumtur teksa bën pazar me fëmijët



Angelina Jolie është parë e buzëqeshur teksa ka bërë pazar në një dyqan të "Louis Vuitton"-it në Beverly Hills të Kalifornisë. Aktorja 43-vjeçare, fituese e Oskarit, kishte veshur një triko të

zezë dhe pantallona me ngjyrë të njëjtë, kurse ishte e shoqëruar nga fëmijët e saj. Angelina së shpejti do ta fillojë punën për filmin e ardhshëm "The Eternals" bashkë me Richard Maddenin dhe Kumail Nanjjanin.



Rita Ora e kënaqur me turin e koncerteve në Gjermani

Këngëtarja e famshme me prejardhje shqiptare, Rita Ora, ka thënë se është ndarë e lumtur nga koncertet që pati në Gjermani. "Gjermani, faleminderit shumë jeni e mrekullueshme

dhe dini se si të festoni. Ju dua", ka shkruar Rita Ora në llogarinë e vet në "Instagram". Këngëtarja Rita Ora ka njoftuar adhuruesit e saj se është bërë edhe ambasadore e UNICEF-it.

Diplomon djali i Michael Jacksonit



Djali i Michael Jacksonit, Princ, ka diplomuar në Universitetin "Loyola Marymount". Kushëriri i tij, TJ Jackson, e ka uruar Princin për

diplomimin, i cili ka qenë bashkë me të edhe në ceremoni. "Princi, ka qenë një rrugë e gjatë, por ju e keni bërë këtë", ka shkruar TJ në llogarinë e vet në "Twitter".

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

Fazliu: Duam fitore në 'Zahir Pajaziti'

Astrit Fazliu ka konfirmuar se Feronikeli edhe ndaj Llapit do ta kërkojë fitoren në Podujevë. "Ne jemi mirë të përgatitur për ndeshjet e fundit. Të gjithë e dimë rëndësinë e pikëve si për ne, po ashtu edhe për Llapin, por Feronikeli si në çdo ndeshje tjetër udhëton për fitore. Kundërshtari ka skuadër cilësore dhe do të jetë ndeshje e vështirë për të dy klubet dhe interesante për publikun", ka thënë Fazliu



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 MAJ - Një nga futbollistët kryesorë të Feronikelit në këtë kampionat, Astrit Fazliu, ka thënë të hënën për "Epokën e re" se skuadra lidere e IPKO Superligës udhëton të mërkurën për fitore në Podujevë. Llapi dhe Feronikeli të mërkurën nga ora 16:00 në stadiumin "Zahir Pajaziti" e zhvillojnë derbin e javës së parafundit në këtë edicion garash. "Ne jemi mirë të përgatitur për ndeshjet e fundit. Të gjithë e dimë rëndësinë e pikëve si për ne, po ashtu edhe për Llapin, por Feronikeli si në çdo ndeshje tjetër udhëton për fitore. Kundërshtari ka skuadër cilësore dhe do të jetë ndeshje e vështirë për të dy klubet dhe interesante për publikun", ka thënë Fazliu, i cili ka konfirmuar se "Nikli" në këtë ndeshje nuk do të ketë mungesa. Ish-sulmuesi i Prishtinës dhe disa

skuadrave të tjera në Kosovë e Shqipëri ka thënë se ndeshja që zhvillohet në Drenas në mes të Feronikelit dhe Prishtinës mund të jetë përcaktuese për titullin e kampionit për edicionin 2018/19. "Është mirë që ne luajmë si vendës ndeshjen e fundit kundër Prishtinës në Drenas. Ajo ndeshje mund të jetë përcaktuese për titull të kampionit në Superligë", ka deklaruar Fazliu. Feronikeli aktualisht është në pozitën e parë, me dy pikë më shumë se skuadra e Prishtinës që pozicionohet e dyta në renditjen tabelore, kurse Llapi është në pozitën e tretë me pesë pikë më pak. Skuadra e Feronikelit ka pasur një sezon fantastik deri më tash, pasi është kualifikuar edhe në finale të Kupës, ku përballet me skuadrën e Trepçës '89, më 25 maj në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Ndërsa të mërkurën do të zhvillohen edhe tri ndeshje të tjera dhe takohen: Prishtina - Trepça '89, Drita-Flamurtari dhe Drenica-Ballkani.

Dukagjini e humb në tavolinë ndeshjen ndaj Vushtrrisë

Komisioni i Garave i Ligës së Parë të Kosovës në futboll mori vendim për regjistrimin e ndeshjes Dukagjini - Vushtrria të regjistrohet me rezultat zyrtar 3:0 në të mirë të skuadrës nga Vushtrria. Ky dënim për skuadrën nga Klina erdhi pasi skuadra e Vëllaznimit është ankuar se futbollisti Granit Elezaj është aktivizuar në lojë pas katër kartonëve të verdhë. "I njëjti është aktivizuar në lojë, andaj kemi shkelje të propozicioneve, pikërisht të nenit 53, paragrafi 1, prandaj ankesa e KF Vëllaznimit miratohet e bazuar dhe ndeshja KF Dukagjini - KF Vushtrria regjistrohet me rezultat zyrtar 3:0 për KF Vushtrria", thuhet në njoftimin e Komisionit të Garave.

SHKURT

Presidenti Meta uron boksierin Jurgen Uldedaj

Boksieri shqiptar Jurgen Uldedaj regjistroi një tjetër sukses të jashtëzakonshëm duke u shpallur kampion bote në kategorinë "Junior WBC" teksa mposhti me pikë 97-93 polakun Tvardovski, në duelin e zhvilluar në Magdeburg të Gjermanisë. Ndërkohë nëpërmjet një postimi në faqen zyrtare, presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka uruar boksierin shqiptar për triumfin e tij. "Shpallja kampion bote në kategorinë 'Junior WBC' e 21-vjeçarit shqiptar Jurgen Uldedaj është një sukses i jashtëzakonshëm për boksion tonë profesionist. Urime të përzemërta për kampionin tonë të pamposhtur në ring dhe paraqitje gjithmonë të shkëlqyera në të ardhmen!", ka shkruar Meta.

Salahi, tifozëve: Na e ktheni Madridin në 'Anfield'

Mohamed Salah në ndeshjen kundër Wolvesit provoi emocione të forta në fund të ndeshjes. Vajza e tij u fut në fushë dhe shënoi gol përpara tifozëve të kuq. Sapo topi i vogëlushes pushoi në rrjetë, tifozët shpërthyen në brohoritma. "Është një ndjesi e ëmbël, por sezoni nuk ka mbaruar. Falënderoj shokët, stafin teknik dhe tifozët. Këtyre të fundit ju them: na e ktheni Madridin në 'Anfield'", ka thënë Salah.

Fansat e Ajaxit përshëndetin Frenkie de Jong

Ajaxi i Amsterdimit siguroi titullin kampion në Eredivisie një javë para përfundimit të kampionatit, pas fitores 4-1 me Utrechtin në "Johan Cruyiff Arena". Një sukses i merituar për "harkëtarët", që mrekulluan me futbollin e tyre edhe në Champions, ku u eliminuan në limitet e kohës shtesë nga Tottenhami. Disa nga "yjet" e Ajaxit do të largohen në klube të tjera të mëdha evropiane, një prej të cilëve është Frenkie de Jong, që ka firmosur për Barcelonën. Mesfushori i talentuar, që pikërisht këtë të diel mbushi 22 vjeç, u përshëndet nga tifozët para se ta nisë aventurën e re në La Liga. Fansat e Ajaxit krijuan një atmosferë të jashtëzakonshme dhe emocionuese, në shenjë falënderimi për futbollistin e ri, për gjithçka ka dhënë për ekipin e njohur holandez.

Më 25-26 maj turneu ndërkombëtar 'Lah Nimani'

PRISHTINË, 13 MAJ - Federata e Boksit e Kosovës për herë të njëmbëdhjetë do ta organizojë Turneun Ndërkombëtar të Boksit "Lah Nimani" për të Rinj

(Youth) 17-18-vjeçar. Sipas njoftimit të Federatës së Boksit, turneu do të jetë dyditorë. Gjysmëfinalët zhvillohen më 25 maj nga ora 16:00, kurse finalët

zhvillohen një ditë më vonë nga ora 12:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. "Për shkak të mungesës së mjeteve financiare kemi ftuar vetëm

gjashtë shtete, edhe pse shumë shtete të tjera kanë shprehur gatishmëri për të marrë pjesë në këtë turne", thuhet në njoftimin e Federatës së Boksit.



Palermo bie në Serinë C

SICILY, 13 MAJ - Tashmë është çdo gjë zyrtare, Palermo u dënua dhe do të jetë pjesë e Serisë C sezonin e ardhshëm. Ky ishte vendimi i Gjykatës Federale Kombëtare (FIGC) e cila ka hedhur poshtë çdo

kontestim të Palermos dhe përfaqësuesve të saj. Dënimi ekzakt është vendi i fundit në Serinë B dhe rrjedhimisht rënia në C. Shkak është bërë falsifikimi i dokumenteve financiare në periudhën

2014-2017 nga krerët e klubit sicilian, duke nisur nga ish-presidenti Mauricio Zamparini. Siç raporton "Il Gornale di Sicilia", klubi do të ketë 48 orë kohë ta apelojë vendimin në Gjykatën e Apelit,

e cila do të vendosë brenda 10 ditëve. Do të jetë shumë e vështirë që të ndërmerret një lehtësim i dënimit. Ndërsa krerët e klubit dhe studioja ligjore pretendojnë t'i zbresin ekipit vetëm 15 pikë.



'Eurobasket' zbulon më të mirët e vitit në Kosovë

PRISHTINË, 13 MAJ - "Eurobasket" e ka zgjedhur ekipin më të mirë të sezonit 2018/19 në kampionatin e Kosovës në basketboll i cili përfundoi javën që shkoi. Në fakt, uebfaqja e njohur evropiane e basketbollit përzgjedhjen e ka bazuar në paraqitjet e basketbollistëve dhe statistikën e tyre gjatë sezonit që po lëmë pas. Në këtë pesëshe i shohim tre basketbollistë të kampionit të ri të Kosovës, Prishtinës dhe dy të finalistit dhe mrekullisë së sezonit, Rahovecit. Dardan Berisha është shpallur MVP i finales, lojtar i vitit, organizator i vitit dhe lojtari më i mirë vendor. Goditësi i vitit është shpallur Fred Richardson III i Rahovecit. Ky i fundit është shpallur edhe lojtari më i rëndësishëm për ekipin e vitit. Qendra e vitit është zgjedhur Khalid Boukichou (Prishtina-Nancy), kurse lojtari më i mirë defansiv Mikaile Tmusiq (Prishtina). Ndërkohë Damir Mulaomerović, pasi e udhëhoqi Prishtinën drejt triumfit në të dy frontet, u shpall trajneri i vitit.



Për herë të parë dy vëllezër rivalë në finalet e NBA-s

OAKLAND, 13 MAJ - Finalja e Konferencës së Perëndimit midis Golden State dhe Portlandit është historike për NBA-në. Për herë të parë në fazën finale "play-off" do të përballen dy vëllezër: Stephen Curry (Golden State) dhe Seth Curry (Portland). Stephen Curry, kampion në fuqi me Golden State, u kualifikua pas triumfit në gjysmëfinale ndaj Houstonit. Ndërsa Seth u kualifikua, pasi Portlandi fitoi në gjysmëfinalen e shtatë të "play-off"-it ndaj Denverit. Kjo do ta vërë në vështirësi familjen Curry, që nuk di se për cilin nga djemtë të bëjë tifo në finalet "play-off" në Perëndim. Dy vëllezërit Curry këtë sezon janë përballur në parket në garën e trepikëshave në mbrëmjen e "All Star Game" të zhvilluar në Charlotte. Në vitin 2017, përballë njëri-tjetrit në fazën "play-off" në NBA ishin edhe dy vëllezërit spanjollë Pau Gasol (San Antonio) dhe Marc Gasol (Memphis). Gjithsesi, kjo përballje ndodhi në raundin e parë "play-off", ndërsa kjo e vëllezërve Curry po ndodh në një finale.



KONFERENCA E LINDJES - FINALE "PLAY-OFF"

Milwaukee - Toronto

KONFERENCA E PERËNDIMIT - FINALE - "PLAY-OFF"

Golden State - Portland

SHKURT

Brightoni shkarkon trajnerin Hughton

Verën e vitit 2017 ekipi i Brightonit u rikthye pas 24 vjetësh në Premierë Ligë pasi përfundoi i dyti në Championship. Sezonin e kaluar shpëtoi ashtu siç bëri edhe sivjet. Brightonit e mbylli kampionatin në vend të 17-të me 36 pikë, dy pikë më shumë se Cardiffi që u rirëzua një kategori më poshtë. Megjithatë, qëndrimi në elitë dhe arritja në gjysmëfinale të FA Cup nuk ka mjaftuar për drejtuesit e klubit nga jugu i Londrës. Presidenti Toni Blum ka shkarkuar Chris Hughtonin nga posti i trajnerit të ekipit. Vendimi erdhi pas humbjes 1-4 kundër Manchester Cityt.

Toure: Nuk jam pensionuar

Mesfushori nga Bregu i Fildishtë, Yaya Toure, ka hedhur poshtë zërat për pensionimin nga futbollit. Ish-anëtari i Barcelonës dhe Manchester Cityt ka thënë se synimi i tij është të luajë edhe për disa vjet të tjera futboll. "Ka pasur shumë paqartësi rreth së ardhmes sime. Dua t'u tregoj të gjithëve se unë e dua futbollin dhe dua të vazhdoj të luaj edhe për disa vjet", ka thënë Toure, i cili muaj më parë është larguar nga skuadra e Olympiakosit.

Tifozët e Evertonit: Liverpooli e humbi titullin në 'Goodison Park'

Tifozët e Liverpoolit janë të pikëlluar që nuk e fituan Ligën Premierë, por që tani e kanë humbur respektin edhe për rivalin e tyre lokal, Evertonin. Në fakt, tifozët rivalë e kanë shijuar çdo minutë dhe kanë festuar prej se 'The Reds' e humbi titullin në ndeshjen e fundit të ligës angleze. "Ju e humbët titullin në 'Goodison Park'", ishin thirrjet e tifozëve të Evertonit brenda stadiumit të tyre. Kjo thirrje e tifozëve kundërshtarë i ka nervozuar jashtë mase ata të Liverpoolit, të cilët kanë reaguar me sharje dhe ofendime në rrjetet sociale. Përveç tifozëve, edhe klubi i Evertonit ka bërë një postim thumbues ndaj Liverpoolit duke e uruar Manchester Cityn për fitimin e titullit.

Valencia largohet nga Unitedi pas 10 vjetësh

Futbollisti Antonio Valencia është larguar nga skuadra e Manchester Unitedit pas 10 vjetësh. 33-vjeçari iu bashkua skuadrës nga "Old Trafford" në vitin 2009 kur kaloi nga Wigani dhe që nga ajo kohë ka luajtur në 339 ndeshje, ku ka fituar 2 Premierë Liga, 1 FA Cup, 2 Carabao Cup dhe 1 Evropa Ligë. "Çdo moment, çdo gëzim do të jetë një thesar në zemrën time. Këtë legjendë e shkruam së bashku", ka deklaruar Valencia.

Nëse Leverkuseni dështon për Ligën e Kampionëve, Brandti largohet

Bayer Leverkuseni ka edhe një ndeshje në dispozicion për t'i provuar shanset për një vend në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm. Në rast dështimi, duket se lojtarët kryesorë mund të largohen. I pari pritet të jetë Julian Brandt, i cili ka një klauzolë largimi vetëm 25 milionë euro. Talenti 23-vjeçar ka shumë admirues dhe një prej tyre është Jurgen Klopp, i cili e pëlqente që kur drejtonte Dortmundin. Drejtuesit e Leverkusenit duan ta rinovojnë kontratën me qëllim rritjen e klauzolës, por Brandt ka vendosur si kusht kualifikimin në Ligën e Kampionëve.



Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës
The Trade Union Health Federation of Kosova
Sindikalna Federacija Zdravstva Kosova

Duke u bazuar ne Vendimin me nr. të prot. 29/18 të datës 30.03.2018 të Kryesisë së Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës -FSSHK, Zyra qendrore e FSSHK-së shpall këtë

FTESË PËR OFERTË

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës bënë ftesë për palët e interesuara për dorëzimin e ofertave për blerjen e një Veture për nevojat e zyrës Qendrore të FSSHK-së.

Ofertuesi duhet të kenë:

Veture të markës: OPEL

Viti: 2006-2010

Kilometrazh të kaluar : 100.000 – 200.000

Lënda Djegëse: Dizel,

Marshi: I preferuar Automatik,

Vetura duhet te jete ne gjendje të rregullt.

Ftesa për ofertë do të jetë e hapur 7 (shtatë) nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Të gjithë të interesuarit duhet të dorëzojnë ofertën me dokumentacionin përcjellës në Zyrën Qendrore të FSSHK-së me adresë: Rr. Mustafa Kruja , Kati-5 Nr.17 , 10000 Prishtine deri me datën 20 Maj 2019, ora 12:00 h. Numri kontaktues 045/588-902 ose 038726-246.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

Zyra e Personelit

Nr.01/609

Më:13/05/2019

Mbështetje në dispozitave të nenit 11, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 15 dhe 17 të Rregullores Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Udhëheqësi i Personelit shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të lira të punës

DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCA DHE BUXHET

1.(Një) Arkëtar.

Shkollimi i kërkuar Bachelor- Drejtimi Ekonomik.

Përvojë pune: 4 vite në profesion.

Kodi i vendit te punës -AD/160/JP00038997

Koeficienti: 6

Përshkrimi i detyrave:

1. Menaxhon dhe mirëmban të gjitha transaksionet e parasë së gatshme në institucion.

2. Kujdeset për sigurinë e të gjitha parave të gatshme në institucion.

3. Planifikon dhe kontrollon të gjitha shpenzimet e parasë së gatshme.

4. Mban evidenca për shpenzimet e parasë së gatshme dhe i sistemon ne regjistrator përkatës.

5. Rishikon raportet, format, dhe të dhënat për saktësinë, plotësinë, dhe përputhshmërinë e tyre lidhur me shpenzimet e parave të gatshme.

6. Përgatit raportet e parave te imta, dhe përgatit raport lidhur me gjendjen e arkës.

7. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

8. Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrat të Drejtorit.

Dokumentet e Kërkuara:

-Diploma ;

-I.ctërnjoftimi (fotokopje);

-Certifikata e lindjes;

-Certifikata për trajnimet e kryera;

-Dëshmi qe nuk është nen hetime

-Vërtetimin e përvojës së punës;

-Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;

-Fletëparaqitjet merren dhe dorëzohen në Zyrën Pritëse, në KK -Malishevë.

-Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit, nuk do të merren në shqyrtim;

-Orari i intervistimit do të publikohet në tabelën e shpalljeve të KK-Malishevë

Afati për paraqitjen e dokumentacionit është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së tij në të përditshmen " Epoka e re" dhe në tabelë të shpalljeve të KK- Malishevë.

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këto vende të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në Zyrën për pritjen e palëve KK- Malishevë.

Për intervistë do të njoftoheni me kohë.

Udhëheqësi i Personelit
Gani Bahtjaraj, jur.dipl.



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**

Republic of Kosovo
Millennium Foundation of Kosovo

Specific Procurement Notice

MEDIA SPECIALIST

RCQ-MFK- 2019/011

The Government of Kosovo has received grant funding of UD\$49,000,000.00 (Forty-Nine Million United States Dollars) from the Millennium Challenge Corporation (MCC) of the United States Government to support Kosovo through a Threshold Program which is designed to lower energy costs for households and businesses and to support the Government of Kosovo in its efforts to improve data transparency to spur growth, fight poverty and advance stability. The Millennium Foundation of Kosovo (MFK), the Accountable Entity created by the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Agreement, intends to apply parts of the proceeds of the funds to payments for Contracts for Goods, Works and Services.

To support this project MFK is seeking one (1) **Media Specialist** for

Millennium Foundation Kosovo (Individual Consultant) to support the project.

Applications submission deadline: 20 May 2019, 16:00 (Kosovo Time).

Interested eligible consultant may refer to the other relevant documents (RCQ/TOR) at: millenniumkosovo.org

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 ☎ +386 49 848 553

Prishtinë



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

